# Kështu mbrojmë femrat që denoncojnë tutorët

**Nga Gentjan Ruko**
**"Koha Jonë", 12.12. 2001**

**Drejtori i policisë: "Kështu mbrojmë femrat që denoncojnë tutorët"**
*Fier, ngrihet për herë të parë një qendër e pritjes së viktimave të prostitucionit*

**FIER** - Ngrihet për herë të parë në Shqipëri një qendër e pritjes dhe e mbrojtjes së viktimave të trafikut të prostitucionit. Nismëtari i saj, drejtori i policisë së Fierit, Xhavit Shala, thotë se e krijoi atë për të strehuar femrat e rrëmbyera ose të mashtruara për prostitucion. "Qendra, që është ngritur në mjediset e policisë së Fierit, krijon kushtet që ato femra, që kapen gjatë rrugës për jashtë shtetit ose që janë kthyer prej andej, të mos kenë frikë për të denoncuar tutorët e tyre. Dhe kjo është veçanërisht e vlefshme derisa në Shqipëri nuk ka një ligj të posaçëm për mbrojtjen e dëshmitarëve", thotë Shala.

Qendra u përurua dje, gjatë një vizite që ambasadori i OSBE-së në Shqipëri, Geert Ahrens, kreu në drejtorinë e policisë së Qarkut të Fierit. Qendra është e përbërë nga dhoma me gjithsej 12 shtretër. Ka aty banja, dushe, salla leximi dhe stola për të pushuar. Qendra administrohet nga dy OJQ të Fierit, të cilat kanë caktuar një kujdestare. Kujdestarja ka nën varësi një nënoficere të policisë. Pjesa tjetër e personelit, një mjek dhe një psikolog, është parashikuar për t'u angazhuar me seanca të herëpasherëshme, sipas nevojave që do të paraqiten.

Vajzat e para janë duke e banuar qendrën. Shala sqaron se qendra nuk duhet ngatërruar me një strehë rehabilitimi. Por ai siguron se qëndrimi në qendër u krijon kushte të mjaftueshme vajzave të rëna viktimë e trafikantëve që ato të dëshmojnë kundër të ashtuquajturve tutorë të tyre, në seancën e sigurimit të provës në gjykatë. Shala thotë se ngulmon që kjo seancë gjyqësore të zhvillohet brenda 10 ditësh, nga momenti që policia përfundon hetimet; në të kundërt qendra nuk mund ti shërbejë mjaftueshëm qëllimit për të cilin është krijuar.

Qëkur Shala mori drejtimin e policisë së Fierit, pothuajse nga janari i këtij viti, rreth 100 trafikantë femrash janë ndjekur penalisht, ose 2,5 herë më shumë se një vit më parë.

Koha Jone 12. 12. 2001

# Drejtori i policisë: "Kështu mbrojmë femrat që denoncojnë tutoret"

*Fier, ngrihet për herë të parë një qendër e pritjes së viktimave të prostitucionit*



Gentian Ruko

**FIER** - Ngrihet për herë të parë në Shqipëri një qendër e pritjes dhe e mbrojtjes së viktimave të trafikut të prostitucionit. Nismëtari i saj, drejtori i policisë së Fierit, Xhavit Shala, thotë se e krijoi atë për të strehuar femrat e rrëmbyera ose të mashtruara për prostitucion. "Qendra, që është ngritur në mjediset e policisë së Fierit, krijon kushtet që këto femra, që kapen gjatë rrugës për jashtë shtetit ose që janë kthyer prej andej, të mos kenë frikë për të denoncuar tutorët e tyre. Dhe kjo është veçanërisht e vlefshme derisa në Shqipëri nuk ka një ligj të posaçëm për mbrojtjen e dëshmitarëve", thotë Shala. Qendra u përurua dje, gjatë një vizite që ambasadori i OSBE-së në Shqipëri, Geert Ahrens, kreu në drejtorinë e policisë së Qarkut të Fierit. Qendra është e përbërë nga dhoma me gjithsej 12 shtretër. Ka aty banja, dushe, salla leximi dhe stola për të pushuar. Qendra administrohet nga dy OJQ të Fierit, të cilat kanë caktuar një kujdestare. Kujdestarja ka nën varësi një nënoficere të policisë. Pjesa tjetër e personelit, një mjek dhe një psikolog, është parashikuar për t'u angazhuar me seanca të herëpashershme, sipas nevojave që do të paraqiten. Vajzat e para janë duke e banuar qendrën. Shala sqaron se qendra nuk duhet ngatërruar me një strehë rehabilit[illegible]. Por ai siguron se qëndrimi në [illegible] mjaftueshme vajzave të rëna viktimë e trafikantëve që ato të [illegible]mojnë kundër të ashtuquajturve tutore të tyre, në seancën e sigurimit të provës në gjykatë. Shala thotë se ngulmon që kjo seancë gjyqësore të zhvillohet brenda 10 ditësh, nga momenti që policia përfundon hetimet; në të kundërt qendra nuk mund ti shërbejë mjaftueshëm qëllimit për të cilin është krijuar. Qëkur Shala mori drejtimin e policisë së Fierit, pothuajse nga janari i këtij viti, rreth 100 trafikantë femrash janë ndjekur penalisht, ose 2,5 herë më shumë se një vit më parë.

# 2 milionë për të

*Në Berat plasin bastet për ndeshjet mes gjela[...]*
*një ekzemplar nga fshati Lumas, i cili ka [...]*

**BERAT** - E rrallë, por e vërtetë. Në komunën e Sumasit 15 kilometër larg qytetit të Beratit, është viti i dytë që ka filluar të aplikohet një sport i ri. Lufta midis gjelave. 20 baste janë vënë deri tani dhe gjeli 15 kilogram ka gllabëruar plot 200 mijë lekë të reja. Janë me qindra fansa fshatarë, të cilët këto ditë të ftohta dimri dhe mungesë të energjisë elektrike të shkundin xhepat e tyre duke vënë për një duel gjelash 2 milionë lekë. Është vërtet një rekord i ri i shqiptarëve të varfër, të cilët hohi të tyre kanë bastet. Jo pak po 20 baste janë vënë për kryegjelin 15 kilogram të Lumasit,



duke i hedhur [...] gjithë kolegët e tij [...] fituar admirimin e [...] pulave. E veçanta [...] kryegjeli i Lumas[...] shpallur garë edhe [...] tjerë të komunës [...]

# Një kryetar komu[...] operatorin e TV[...]

**LEZHË** - Një kryetar komune ka kërcënuar, sharë dhe pështyrë një nga kameramanët e televizionit lokal "Lezha TV". Shkaku, sipas denoncimit të bërë në polici nga i dëmtuari, ka qenë një kronikë ku kryetari i Komunës së Zejmenit, Gjergj Toma, përfaqësues i PD-së, dhe kryetari i komunës Shënkoll Gjergj Kqira, përfaqësues i PS-së, kritikoheshin nga banorët e zonave të tyre, në lidhje me konfliktet për tokën në komunat e Zejmenit dhe në komunën Shënkoll.

Ndërkohë që në sajë të imunitetit të tij si kryetar komune, policia nuk ka kryer asnjë veprim përveç



marrjes së padisë [...] e të dëmtuarit. N[...] ndodhur të hënën [...] ditë. Kryetari i [...] Zejmen Gjergj To[...] e ka thirrur për nj[...] një nga lokalet [...] të qytetit e ka g[...] nonjësin e TV L[...] më pas e ka sharë [...] duar me një fjalo[...] kontë. I dëmtuar[...] "Goditja ka ardh[...]

Për të qarë e për të qeshur nga Lezha